



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.154/ 2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër Milazim Musliu, për shkak të identifikimit të kartelës falsë, në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Raundin e II (dytë), për Kryetar të Komunës së Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 30.05.2012, mori këtë vendim:

#### VENDIM

- I. PZAP-i shpallet inkompetent për të vendosur në këtë çështje juridike.
- II. Shkresat e lëndës ti dërgohen Prokurorisë Publike Kompetente në procedurë dhe vendosje të mëtejshme.

#### Arsyetim

PZAP, ka pranuar një ankesë me datë 27.05.2012, nga subjekti politik PDK, dega në Ferizaj, në të cilën pretendohet se në Qendrën e Votimit (QV) 2515/D në Vendvotimin Nr. 3, në shkollën fillore “ Mic Sokoli”, në fshatin Slivovë- Ferizaj, aktivisti i subjektit politik të LDK-së, Milazim Musliu, është paraqitur në cilësinë e vëzhguesit pranë kësaj QV, me kartelë identifikimi falsë.

Sipas pretenduesit të ankesës personi i lartshënuar , është i njohur nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), dhe Policia e Kosovës, si person nën hetim, për shkak të manipulimit të procesit zgjedhor në Zgjedhjet Parlamentare te vitit 2010.

PZAP-i, pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

PZAP-i nuk është kompetent për të vendosur në këtë çështje juridike.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se në këtë çështje ka elemente të veprës penale nga neni 332 i KPK-së, dhe lidhur me këtë ka kompetencë për të vendosur Prokuroria Publike Kompetente.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

Anr.154/2012 më datën 30.05.2012.

Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha

